



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR TIRANË

NR.719 S.P / 1104 REGJ.THEM.

NR. 630 VENDIMI

V E N D I M

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane e përbërë prej :

GJYQTAR - ARTAN GJERMËNI

Asistuar nga sekretare gjyqësore **Ornela BALLA**, sot më datë **09.03.2022** mori në shqyrtim, në séance gjyqësore me dyer të hapura, me gjykim të shkurtuar, çështjen penale me **Nr. 1104 Regj.Them**, që i përket;

KËRKUESE: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane, përfaqësuar nga prokurori Ylli Bashaj.

KUNDËR TË PANDEHURIT: Valmir Luto - i biri i Kastriot dhe i Meleqe, i datëlindjes 12.04.1992, lindur në Ballsh dhe banues në Tiranë, me adresë: Rruga “Pandi Dardha”, beqar, me arsim 8-klasë, me shtetësi dhe kombësi shqiptare, mbrojtur nga avokati i zgjedhur Erjon Kullolli-me Nr.10128 License dhe NIPT L91408017A, Anetare i Dhomes së Avokatise Tirane.

AKUZUAR: Për kryerjen e veprës penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, të parashikuar nga neni 283/1 të Kodit Penal.

Gjykata pasi dëgjoi pretendimet e palëve, mori e administroi provat e nevojshme, dëgjoi përfundimisht palët që kërkuan:

Prokurori: Të deklarohet fajtor i pandehuri Valmir Luto, për veprën penale të “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, që parashikohet nga neni 283/1 i K.Penal dhe dënimin e tij me burgim.

Avokati dhe i pandehuri:

-Deklarimin fajtores të të pandehurit Valmir Luto dhe dënimin e tij me minimumin e përcaktimit ligjor nga neni 283/1 i K.Penal.

-Aplikimin e nenit 59 të K.Penal duke vendosur pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim duke u vendosur në shërbim prove.

V Ë R E N:

Pranë Gjykates së Rrethit Gjyqësor Tirane, nga ana e organit të akuzes është paraqitur kërkesa për gjykim në ngarkim të të pandehurit Valmir Luto ,i akuzuar për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikeve ”, të parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal.

Gjykata vëren se, në bazë të nenit 69, 74 dhe 76/1 të K.Pr.Penale, kjo çështje hyn në juridiksionin gjyqësor penal dhe është në kompetencë lëndore e tokësore të kësaj gjykate.Gjykata çmon se është kompetente për të shqyrtuar kërkesën e prokurori për dërgimin e çështjes në gjyq, konform neneve 13/2/c dhe 332 e vijues të K.Pr.Penale.

Kërkesa për dërgimin e çështjes në gjyq vlerësohet se i përmban elementët formalë për vlefshmërinë e saj. Ajo i përmban elementet e pikës 3 të nenit 331 të K.Pr.Penale (gjenealitetet e të pandehurit, parashtrimin e faktit penal dhe cilësimin juridik të veprës, burimet e provës dhe faktet që ato u referohen etj). Në referim të pikës 2 të nenit 331 dhe nenit 327 të K.Pr.Penale i pandehuri është njohur me të drejtat e tij procedurale (me përfundimin e hetimeve paraprake; me të drejtën që ka për t’u njohur e për të marrë aktet e fashikullit; është pyetur dhe ka dhënë deklaratime etj.).Gjykata konstaton gjithashtu se kërkesës për dërgimin në gjyq i janë bashkëlidhur të gjitha aktet dhe provat që përmban fashikulli i hetimeve, si dhe aktet e tjera, konform pikës 4 të nenit 331 të K.Pr.Penale.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor të kërkesës për gjykim në seancë paraprake, në referim të nenit 332/c, pika 2 e K.Pr.Penale, prokurori paraqiti në mënyrë të përmbledhur rezultatet e hetimeve paraprake dhe provat ku mbështetet kërkesa për dërgimin në gjyq të të pandehurit.Në parashtrimet e tij mbrojtësi i të pandehurit si dhe i pandehuri nuk ngritën pretendime në këtë fazë të procesit, si dhe paraqiti kërkesën për gjykim të shkurtuar, konform nenit 332/c, pika 4 të K.Pr.Penale.I pandehuri i pranishme kërkoi personalisht të procedohet me gjykim të shkurtuar.

Gjykata,verifikoi gjendjen e akteve të fashikullit në zbatim të neneve 332/c, 332/dh, pika 1, shkronja “c” dhe 405, pika 7 e K.Pr.Penale.Nuk u konstatuan akte absolutisht të pavlefshme apo prova të papërdorshme në këtë çështje.Duhet të vihet në dukje se as nga pala e pandehur nuk u parashtruan kërkesa lidhur me pavlefshmërinë e akteve të hetimeve paraprake apo papërdorshmërinë e provave.Me kryerjen e këtyre verifikimeve, gjykata u bind gjithashtu se hetimet paraprake janë të plota dhe se gjykimi i themelit të akuzës së ngritur ndaj të pandehurit mund të zhvillohet në gjendjen që janë aktet në fashikullin e prokurorisë të sjellë për gjykim, pa patur nevojë të merren prova të tjera. Prandaj, gjykata, bazuar në nenin 332/dh, pika 1, shkronja “c” dhe nenin 405, pika 6 të K.Pr.Penale, duke çmuar se çështja mund të zgjidhet në gjendjen e akteve, vendosi të pranojë kërkesën e të pandehurit për gjykim të shkurtuar dhe të procedojë në vijim me këtë rit të posaçëm gjykimi.

Në mbështetje të dispozitave të posaçme procedurale të prezantuara më sipër, si dhe të jurisprudencës unifikuese të Gjykatës së Lartë, riti i posaçëm i gjykimit të shkurtuar eviton marrjen e provave në seancë gjyqësore dhe debatin lidhur me to.Në këto kushte, fashikulli (dosja hetimore) i prokurorit kthehet në fashikull gjykimi (dosje gjyqësore).

duke marrë vlerën e provës pas pranimit të kërkesës për gjykim të shkurtuar. Në zbatim të nenit 332/ë, pika 4 e K.Pr.Penale, u krijua fashikulli i gjykimit që përmban aktet e hetimit paraprak dhe provat e grumbulluara në kuadër të procedimit penal, si dhe aktet e kryera gjatë seancës paraprake nga kjo gjykatës.

Nga gjykimi rezultoi e provuar se: Nga ana e Prokurorise pranë Gjykatës së Shkalles së Pare Tirane referuar materialit kallëzues, është regjistruar procedimi penal për veprën penale të parashikuar nga neni 283/1 të K.Penal, në ngarkim të shtetasit Valmir Luto.

Nga hetimet e kryera për këtë çështje ka rezultuar se më datë 25.08.2021, rreth orës 23.00, punonjësit e policisë të DVP Tiranë në shërbim në rrugën “Ndre Mjeda”, në zonën e ish-parkut të autobuzave, pranë vendit të quajtur Zogu i Zi, Laprakë. Shërbimet policore kanë konstatuar të arrestuarin Valmir Luto, në drejtim të automjetit me targa AB 319 AY, dhe i kanë bërë shenjë ndalimi. Pas ndalimit të automjetit dhe kontrollit të Valmir Lutos, i janë gjetur 5 (pesë) qese transparente të mbushura me një sasi pluhuri të bardhë për nga karakteristikat si lëndë narkotike e kokainës. Këto qese i arrestuari i kishte fshehur në gojë. Lënda e gjetur si më sipër u sekuestrua në cilësinë e provës materiale dhe pas peshimit rezultoi me peshë 2 (dy) gram me gjithë ambalazh. Lënda u fut në qesen e provave materiale me numër unik dhe lidhur me të u mor vendimi për krverjen e ekspertimit kimik.

I pyetur në prani të mbrojtësit i arrestuari deklaroi se, është përdorues i lëndës narkotike kokainë, sasinë që i është gjetur e kishte për përdorim personal dhe momenti i fundit kur e ka konsumuar ka qenë para rreth tre ditësh.

Në vijim u morën për ekspertim dhe mostra urine të të arrestuarit që u dërgua për ekspertimin përkatës toksikologjik, pasi ai dyshohet se, ka drejtuar automjetin në të cilin e ka ndaluar policia nën efektin e lëndëve narkotike.

Nga këqyrja e pjesshme e përmbajtjes së telefonit që kishte në disponim i arrestuari, dyshohet se, ai e ka konsumuar veprën penale në fjalë në formën e shitjes së lëndës narkotike, çka tregon rrezikshmëri më të lartë.

Shtetasi Valmir Luto është pyetur në cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime për veprën penale “Prodhim dhe shitje narkotikesh”, parashikuar nga neni 283/1 i K. Penal, dhe ka deklaruar se lenda narkotike që i është gjetur me vete është e tij, e ka pasur për përdorim vetjak, pasi është përdorues i lëndës narkotike prej disa vitesh.

Nga OPGJ janë përpiluar vendimet e ekspertimit kimik dhe toksikologjik lidhur me rastin si dhe janë administruar raporti i shërbimit si dhe proces-verbali i kapjes në flagrance e të dyshuarit.

Nëpërmjet të dhënave të pasqyryara në konkluzionet e aktit të ekspertimit toksikologjik-ligjor të urinës së shtetasit Valmir Luto, me Nr.2176 datë 15.09.2021, është arritur në

konkluzionin se në urinën e tij ,nuk është zbuluar prania e produkteve të metabolizmit të cocainës .

Ndërsa nëpërmjet të dhënave të pasqyryara në konkluzionet e aktit të ekspertimit për materialet në ngarkim të shtetasit Valmir Luto ,me Nr.11495 datë 10.11.2021 mësohet se analiza me GC/MS për materialet object ekspertimi treguan për praninë e kokainës ,dhe pesha e tyre pa ambalazh është 1.602 gram.

Sa më sipër organi i akuzën e akuzon të pandehurin Valmir Luto për veprën penale “ Prodhimi dhe shitja e narkotikeve ”, të parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal.

Sa më sipër u provua me

Fashikullin e procedimit penal të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tirane Nr.5803 viti 2021.

Mbi bazën e këtyre fakteve,nga organi i akuzës u kërkua deklarami fajtor i të pandehurit Valmir Luto për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikeve” të parashikuar nga neni 283/1 i K.Penal,dhe dënimin e tij me burgim në masën e përcaktuar në pjesën hyrëse të këtij vendimi, duke u parashtruar se me veprimet e tij të kryera me dashje, i pandehuri ka konsumuar elementet e veprës penale të parashikuar nga neni 283/1 i K.Penal. Arsyetimi i Gjykates, argumentat juridike, interpretimi dispozitave penale, analiza e provave.

Për të vlerësuar përgjegjësinë penale të të pandehurit Valmir Luto në lidhje me veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikeve”të parashikuar nga neni 283/1 i K.Penal.gjykata cmon të nevojshme të analizoje si më poshtë vijon.

Në përmbajtjen e nenit 283 të K.Penal, të miratuar me Ligjin Nr.7895, datë 27/01/1995, sanksionohet se:

“Shitja, ofrimi për shitje, dhënia ose marrja në cdo formë, shpërndarja, tregtimi, transportimi, dërgimi, dorëzimi, si dhe mbajtja, përveç rastit të përdorimit vetjak dhe në doza të vogla, të substancave narkotike dhe psikotrope, si edhe i farërave të bimëve narkotike, në kundërshtim me ligjin ose në kapërcim të përmbajtjes së tyre, dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet.

Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga shtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.

Organizimi, drejtimi apo financimi i kësaj veprimtarie, dënohen me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet.”

Në lidhje me objektin e veprës penale, “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, të parashikuar nga neni 283 paragrafi i parë i Kodit Penal, Gjykata thekson se ai mund të indentifikohet si i dyfishtë në objekt parësor dhe në objekt dytësor. Objekti parësor janë marrëdhëniet juridike që garantojnë shitjen, blerjen, shpërndarjen transportimin, mbajtjen dhe përdorimin sipas dispozitave ligjore përkatëse të lëndëve narkotike e psikotrope, nga veprime të kundraligjshme e shoqërisht të rrezikshme, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në

shëndetin e personit, funksionimin normal të veprimtarisë së organeve jetësore të tij. Kjo dispozitë përjashton nga përgjegjësia personale përdoruesit e lëndëve narkotike duke përcaktuar si kritere mbajtjen në doza të vogla, ndërsa përgjigjen penalisht pavarësisht se është përdorim vetjak kur sasia e mbajtur është e madhe. Ndërsa objekti dytësor i kësaj vepre penale janë marrëdhëniet juridike të vendosura nga ligji për të garantuar paprekshmërinë e rendit dhe qetësisë publike, jetës dhe shëndetit të njeriut. Kjo tërësi marrëdhëniesh juridike dhe jo vetëm janë të mirat publike dhe të të mbarë shoqërisë që justifikojnë dhe përligjin ekzistencën e legjislacionit penal.

Në lidhje me anën objektive të figurës së veprës penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, Gjykata thekson se ajo është element i domosdoshëm për përgjegjësinë penale, sepse nëse nuk ka veprim ose mosveprim të dënueshëm nuk ka vepër penale. Për të patur konsumimin e kësaj vepre penale parimisht duhet që i pandehuri, subjekti aktiv i saj, të kryejë njërën prej veprimeve aktive që dispozita e mësipërme liston në mënyrë kufizuese dhe të mbyllur, e konkretisht:

(i) shitja, me të cilën kuptohet dhënia e lëndës narkotike, të substancave narkotike, lëndëve psikotrope apo i farërave të bimëve narkotike një tjetri kundrejt cmimit, të cfarëdo sasive qoftë por e kufizuar kjo në një veprim konkret apo e shumta në disa veprime pa një lidhje të qëndrueshme, pa një mendim unik e vazhdues kriminal, e me frekuenca jo të rregullta të ndodhjes së saj. Gjykata vlerëson se mjafton një transaksion i tillë për ta quajtur të konsumuar këtë figurë të veprës penale.

(ii) ofrimi për shitje, me të cilin kuptohet shfaqja e vullnetit në mënyrë të padvshimtë të poseduesit të lëndës narkotike, substancave narkotike, lëndëve psikotrope apo farërave të bimëve narkotike dikujt për ta shitur atë. Gjykata vlerëson se, shfaqja e vullnetit të poseduesit të lëndës ligjërisht të ndaluar është e nevojshme dhe e domosdoshme për të patur këtë figurë vepre penale.

(iii) dhënia ose marrja në çdo formë si figurë konkrete e veprës penale e cila përfshin të gjitha llojet e veprimeve që kalojnë posedimin e lëndës narkotike, substancave narkotike, lëndëve psikotrope apo farërave të bimëve narkotike, të pa përfshira në dispozitë, p.sh. shkëmbimi, dhurimi etj. Edhe në këtë rast, vlerëson Gjykata veprimi kriminal konkret ndodh një herë apo edhe disa herë, por pa u bërë qëllim në vetvete dhe mjaftueshëm i shkëputur në kohë sa për të mos u ravijëzuar si veprimtari e vazhdueshme apo e qëndrueshme kriminale.

(iv) transportimi, me të cilin kuptohet zhvendosja e lëndës narkotike nga një vend në një vend tjetër, pa qenë nevoja për veprime të tjera.

(v) dërgimi, i cili është figurë mjaft e ngjashme me transportimin e lëndës narkotike, porse dallohet nga transportimi për shkak se ka një instensitet më të ulët fizik të zhvendosjes së saj. Dërgimi është një formë e ndërmjetme midis transportimit dhe dorëzimit si figura të veçanta kriminale.

(vi) dorëzimi është veprimi fizik i lënies së lëndës narkotike, substancave narkotike, lëndëve psikotrope apo farërave të bimëve narkotike në destinacionin e porositur.

(vii) mbajtja, si figurë konkrete kriminale është posedimi i qëndrueshëm dhe i vazhdueshëm i lëndës narkotike, substancave narkotike, lëndëve psikotrope apo farërave të bimëve narkotike nga një subjekt në vende të caktuara. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës

së Lartë kanë pranuar se kjo figurë vepre penale mund të quhet e konsumuar edhe pa u vërtetuar qëllimi si element i anës subjektive.

(viii) shpërndarja, me të cilën kuptohet tërësia e veprimeve fizike transportuese, dërguese, dorëzuese apo dhënie në çdo formë, në mënyrë të përsëritur të lëndës narkotike,

substancave narkotike, lëndëve psikotrope apo farërave të bimëve narkotike në një apo disa pika të ndryshme, e shtrirë në kohë në mënyrë të vazhdueshme dhe të qëndrueshme nën një mendim unik kriminal.

(ix) tregtimi i lëndës narkotike, substancave narkotike, lëndëve psikotrope apo farërave të bimëve narkotike, si figurë konkrete e veprës penale presupozon krijimin e një veprimtarie tregtare të subjektit aktiv të veprës penale me këto lëndë, e shtrirë në kohë në mënyrë të vazhdueshme dhe të qëndrueshme nën një mendim unik kriminal.

Gjykata vlerëson se, neni 283, paragrafi I i Kodit Penal është një dispozitë blankete për shkak se shprehet "... në kundërshtim me ligjin ose në kapërcim të përmbajtjes së tyre ...". Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se veprimet e mësipërme aktive të subjektit aktiv të veprës penale duhet të jetë në kundërshtim me parashikimet e ligjit që rregullon regjimin juridik të lëndëve narkotike, substancave narkotike, lëndëve psikotrope apo farërave të bimëve narkotike, e konkretisht Ligjit Nr. 7975 të datës 26.07.1995 "Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope", i ndryshuar.

Lidhur me mbajtjen, si një nga format e kryerjes së kësaj vepre penale, Ligjvënësi, si kriter përcaktues për ekzistencën e vetë figurës së krimit dhe, për pasojë, të bazës së përgjegjësisë penale për personat që e konsumojnë atë, ka parashikuar dy rrethana specifike:

(i) mbajtjen e substancave narkotike dhe psikotrope, si dhe të farëve të bimëve narkotike jo për përdorim vetjak dhe (ii) edhe kur rezultojnë i provuar fakti që, këto lëndë mbahen nga personi për përdorim vetjak, në aspektin sasior, ato nuk duhet të jenë në doza të vogla.

Përsa i përket rrethanës së parë, Gjykata thekson se ajo është rrethanë fakti - rezultat i procesit të të provuarit nëpërmjet analizës që bëhet nga Gjykata konform dispozitave procedurale penale për të arritur në përfundime të drejta, nëse lënda narkotike dhe psikotrope, etj. mbahet nga personi për përdorim vetjak apo për të kryer në vijim, ndonjërin apo disa nga veprimet e tjera të përmendura në dispozitë, që janë elementë të anës objektive të figurës së krimit të prodhimit dhe shitjes së narkotikëve.

Gjithashtu, Gjykata thekson se, rrethana "përdorimi vetjak" nuk qëndron më vete, në kuptimin që bazuar vetëm në ekzistencën e saj të konkludohet se nuk ekziston figura e krimit të parashikuar në nenin 283 të Kodit Penal. Përkundrazi, për të mos u marrë mbajtësi i lëndëve të tilla në përgjegjësi penale duhet të provohet se ekziston edhe rrethana e dytë, që ka lidhje me sasinë e këtyre lëndëve, e cila, sikurse shprehet ligjvënësi në vetë dispozitën e përmendur, duhet të jetë "në doza të vogla".

Gjykata vëren se në nenin 283/1 të Kodit Penal, ligjvënësi përdor nocionin juridiko-penal "në doza të vogla", pa bërë ndonjë përcaktim numerik të sasisë së lëndëve të ndaluara që do të shprehte në peshë sasinë e dozës për t'u konsideruar e vogël. Kolegjet e Bashkuara të

Gjykatës së Lartë në Vendimin Unifikues nr. 1, datë 27.03.2008 janë shprehur se, doza e vogël, në kuptimin ligjor të saj, konsiderohet jo ndarja fizike në disa të tilla, por sasia e lëndës apo substancës narkotike e psikotrope që ajo përmban si e tërë dhe që sipas ekspertëve vlerësohet si dozë e vogël. Po sipas këtij vendimi: “Përdoruesi i lëndëve narkotike, i cili e mban atë jo për përdorim vetjak, goftë edhe në doza të vogla, kur është shpërndarës i saj në një nga format që parashikon neni 283/1 i K.Penal, ka përgjegjësi penale sipas kësaj dispozite. Cmojnë gjithashtu se, përcaktimi i dozës së vogël të lëndës narkotike e psikotrope, për efekt të zbatimit të dispozitës së nenit 283 të K.Penal, duhet të bëhet me ndihmën e specialistëve të fushës (toksikologë, etj.), të thirrur si ekspertë dhe rast pas rasti, jo vetëm sipas llojit të lëndës narkotike e psikotrope, por edhe të cilësive fiziko-biologjike dhe shkallës së vartësisë nga droga të personit konkret-mbajtës i lëndës narkotike dhe psikotrope.”

Gjithashtu, në përcaktimin e “dozës së vogël për përdorim personal”, Gjykata mban parasysh vendimin njësuës Nr. 138, datë 16.11.2017 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, në të cilin ky Kolegj shprehet se: “Në aspektin ligjor, formulimi i nenit 283 të Kodit Penal parashikon një dënim penal të vetëm, pa bërë dallim, mbi llojet e drogave në droga të lehta dhe në droga të rënda, si dhe të sasisë së mbajtur. Ky Kolegj vlerëson se, në bazë të dispozitës ligjore të parashikuar në nenin 283 të Kodit Penal, duhet bërë një dallim për sa i përket kriminalizimit të atyre sjelljeve penalisht të dënueshme që kanë të bëjnë: i) me mbajtjen e lëndës narkotike për qëllim shitjeje, ofrimi, dhënieje a marrjeje, shpërndarjeje, transportimi, dërgimi, dorëzimi, etj. ii) në raport me atë të mbajtjes për përdorim personal. Në vlerësimin e ligjvënësit tregtimi, transportimi, shitja apo shpërndarja e lëndëve narkotike nuk janë të vetmet veprime që përbëjnë një rrezik potencial, pasi edhe blerja, edhe mbajtja e këtyre lëndëve paraqesin gjithashtu rrezik, për shkak se krijojnë mundësinë që ato të shpërndahen te palët e treta, pra të kalojnë nga një individ tek tjetri pa asnjë kontroll.

Kolegji vlerëson se shpërndarja e drogës tek të tjerët, në të gjitha format si shitja, ofrimi për shitje, dhënia ose marrja në çdo formë, shpërndarja, tregtimi, transportimi, dërgimi, dorëzimi, si dhe mbajtja, pra shpërndarja në çdo formë goftë falas përmes dorëzimit apo dhënies, apo kundrejt pagesës përbën një veprë penale të dënueshme nga neni 283 i Kodit Penal. Pra, mbajtja për qëllim shitjeje, ofrimi, dhënieje a marrjeje, shpërndarjeje, transportimi, dërgimi, dorëzimi, përbën një veprim penalisht të dënueshëm. Ndërsa rasti për përdorim personal, në doza të vogla, nuk përbën veprë penale. Kjo për arsye se nëse blerja dhe mbajtja e substancave narkotike kufizohet në sasi të vogla, për përdorim vetjak të rastit, rreziku konkret që këto lëndë të kalojnë te një person i tretë nuk është domethënës, për pasojë interesi publik për të vendosur dënime penale në këto raste nuk është i justifikuar. (...) Kolegji vlerëson se përcaktimi i konceptit dozë e vogël për qëllime të përdorimit personal dhe për pasojë i përcaktimit të kufirit të cënueshmërisë së nevojshme të marrëdhënies juridike të mbrojtur nga neni 283 i Kodit Penal, nuk duhet të jetë i lidhur automatikisht në bazë të sasisë së vogël të lëndës narkotike. Kjo për faktin se kërkohet një vlerësim në tërësi i të gjitha rrethanave dhe provave të rastit konkret, pra jo në mënyrë të vetme apo të izoluar. Vlerësimi i konceptit të dozave të vogla për qëllim përdorimi personal duhet bëhet nga ana e gjykatave të themelit mbi bazën e provave të drejtpërdrejta, apo të tërthorta dhe mbi bazën e rrethanave objektive të vlerësuar në tërësinë e tyre me

dinamikën e faktit dhe rrethanat e ngjarjes penale në përputhje me nenin 152 të Kodit të Procedurës Penale. Kështu, mund të ketë edhe raste kur megjithëse nuk tejkalohej kriteri i sasisë së vogël të mbajtjes së lëndës narkotike, për nga rrethanat e tjera, sic janë: prania e gjetjes së mjeteve që shërbejnë për paketimin, apo të dhëna të tjera provuese; arrihet të provohet, te çdo dyshimi, qëllimi për përdorim jo vetjak i dozave, pavarësisht se në dukje relativisht të vogla. Në mënyrë të anasjelltë, edhe tejkalimi automatik i kriterëve të referuara si doza të vogla, nuk do të thotë automatikisht se nuk përjashtohet qëllimi i mbajtjes për përdorim personal, kur rrethanat e ngjarjes e përjashtojnë këtë qëllim dhe provohet se personi është konsumues i një sasive të caktuar të lëndës narkotike.”

Në lidhje me anën subjektive, Gjykata vlerëson se, figura e veprës penale të “Prodhimi dhe Shitja e Narkotikëve” parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal kërkon si formë faji dashjen e drejtëpërdrejtë. Gjithashtu, gjykata vlerëson se, ana subjektive e figurës së veprës penale zbulohet dhe qartësohet nëpërmjet anës objektive, sepse proceset e brendshme psikike dhe psikologjike jo vetëm që ngacmohen nga faktorë të jashtëm, por edhe materializohen në veprimtarinë kriminale gjatë dhe nëpërmjet procesit të zhvillimit të anës objektive.

Në lidhje me subjektin e veprës penale, Gjykata vlerëson se që të ketë përgjegjësi penale duhet që, në kohën e krimit të ketë mbushur moshën katërmëdhjetë vjeç (neni 12 i Kodit Penal), si dhe të jetë i përgjegjshëm (neni 17 i Kodit Penal).

Gjykata, thekson se për të pasur një figurë konkrete të veprës penale është e domosdoshme ekzistenca e të gjithë elementëve përbërës të saj të marra së bashku, të cilët janë: a) objekti i veprës penale; b) ana objektive; c) subjekti dhe ç) ana subjektive. Provueshmëria e elementëve objektive dhe subjektive të figurës së veprës penale, shërben si bazë për të vënë një person përpara përgjegjësisë penale. Gjithashtu, vepra penale paraqet në vetvete një unitet të të gjithë elementëve të figurës së saj. Ajo konsiderohet e kryer në mënyrë të plotë atëherë kur ekzistojnë të katër elementët e saj: objekti, ana objektive, subjekti dhe ana subjektive. Nëse mungon njëri prej këtyre elementëve, vepra penale nuk ekziston.

Gjykata pasi analizoi provat shkresore, krijoi bindjen e saj të bazuar në këto akte dhe në ligj, se i pandehuri Valmir Luto , ka konsumuar elementët e figurës së veprës penale të “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, të parashikuar nga neni 283/1 të Kodit Penal.

Nga pikëpamja e objektit të kësaj vepre penale, e cila merr në mbrojtje marrëdhëniet juridike që garantojnë shitjen, blerjen, shpërndarjen transportimin, mbajtjen dhe përdorimin sipas dispozitave ligjore përkatëse të lëndëve narkotike e psikotrope, nga veprime të kundraligjshme e shoqërisht të rrezikshme, të cilat ndikojnë drejtëpërdrejt në shëndetin e personit, funksionimin normal të veprimtarisë së organeve jetësore të tij, rezulton se, në rastin konkret, provohet që ky objekt është cenuar nga i pandehuri, pasi me veprimet e tij, i pandehuri e ka kryer veprën penale.

Nga pikëpamja e anës objektive, Gjykata cmon se provohet te çdo dyshimi të arsyeshëm se i pandehuri Valmir Luto e ka konsumuar nga ana objektive veprën penale për të cilën akuzohet.

Nga pikëpamja e anës subjektive, gjykata çmon se i pandehuri Valmir Luto , ka vepruar me dashje të drejtpërdrejtë, pasi ai ka parashikuar karakterin shoqërisht të rrezikshëm të veprimeve të tij dhe ka vepruar në mënyrë të kundërligjshme e të vullnetshme, duke mbajtur në mënyrë të paligjshme lëndës narkotike .

Nga pikëpamja e subjektit, në rastin konkret, i pandehuri në kohën e krerjes së veprës penale ka qënë mbi 18 vjeç, dhe rrjedhimisht Gjykata, në vështrim të nenit 12/1 të Kodit Penal, çmon se në drejtim të moshës i pandehuri, ka qënë madhor e i përgjegjshëm penalisht në datën e krerjes së veprës penale, objekt gjykimi dhe si tillë ai ka patur moshën për përgjegjësi penale. Gjithashtu, në çështjen objekt gjykimi nuk u provua që i pandehuri të vuajë nga ndonjë turbullim psikik ose neuropsikik që ka prishur tërësisht ekuilibrin e tij mendor dhe për pasojë nuk ka qënë në gjëndje të kontrollojë veprimet apo mosveprimet e tij dhe as të kuptojë se kryen vepër penale. Përkundrazi me veprimet e tij provohet që ai ka qënë i aftë të posedojë aftësi intelektuale dhe vultive për të kuptuar dhe vlerësuar sjelljen e tij dhe t'a kontrollojë atë. Në këto kushte, gjykata vlerëson se i pandehuri është subjekt i përgjegjshëm penalisht.

Sa më sipër u arsyetua, Gjykata arrin në përfundimin se i pandehuri Valmir Luto,duhet të deklarohet fajtor për veprën penale të “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal.

Në lidhje me llojin dhe masën e dënimit për të pandehurin Valmir Luto.

Gjykata ka detyrimin ligjor të marre në konsiderate rrezikshmerine shoqërore të veprës penale e reflektuar në rëndësinë e padiskutueshme të marrëdhënieve juridike që prek, mënyren dhe formën e krerjes së veprës penale, llojin dhe sasinë e lëndës narkotike të sekuestruar.

Gjykata bazuar në nenin 47, 48, 49 të K.Penal merr parasysh, shkallën dhe formën e fajit të të pandehurit në krerjen e veprës penale (dashje direkte), rrezikshmerine shoqërore të veprës penale dhe autorit (i padënuar më parë),qëndrimin e mbajtur në hetim e gjykim për veprën penale të kryer,sasinë e lëndës narkotike të sekuestruar si dhe moshën e të pandehurit.

Lidhur me masën e dënimit me burgim që duhet të caktohet ndaj të pandehurit, në një vlerësim të hollesishem të rrethanave të mësipërme të çështjes të analizuara prej saj,dhënia e masës së dënimit me burgim të përcaktuar nga neni 283/1 të K.Penal,cmohet nga Gjykata se do të realizojë njëkohësisht jo vetëm qëllimin e ndëshkimit të të pandehurit për veprën penale te kryer, por edhe atë të rehabilitimit,edukimit dhe riintegrimit të të pandehurit në të ardhmen në shoqëri.Sa më sipër në një vlerësim të hollesishem të përmbajtjes,konstatimeve si dhe të të gjitha rrethanave të krerjes së veprës penale nga i pandehuri,Gjykata konkludoi se lloji i dënimit me burgim për të pandehurin i kërkuar nga organi i akuzës mirëpritet nga gjykata, pasi ai është në raport të drejte me vlerësimin e rrethanave të krerjes së veprës penale.Dhënia e masës së dënimit me burgim cmohet nga Gjykata se do të realizojë njëkohësisht jo vetëm qëllimin e ndëshkimit të të pandehurit për

veprën penale të kryer, por edhe atë të rehabilitimit, edukimit dhe riintegrit të të pandehurit në të ardhmen në shoqëri.

Gjykata,duke marre në vleresim të vecante moshën e të pandehurit, e lidhur kjo me rrezikshmerine e pakët të të pandehurit si i padënuar më pare,qëndrimin e mbajtur ne hetim e gjykim për veprën penale të kryer,rrethanave familjare, faktin qe i pandehuri është përdorues i lëndëve narkotike ,rrethanave të kryerjes së veprës penale si dhe të sjelljes pas kryerjes së veprës penale, në respektim të kërkesave të nenit 59 të K.Penal,vlerëson njëkohesisht të aplikoje ndaj të pandehurit dënimin alternativ të “Pezullimit të ekzekutimit të vendimit penal dhe vënien ne kohe prove te tij mase kjo e kërkuar edhe nga i pandehuri dhe mbrojtësi i tij,duke e cmuar të bazuar ne raport me rrethanat e kryerjes së vepres dhe rrethanat lehtesuese te pranishme ne rastin në shqyrtim.

Gjykata cmon që gjate periudhes së proves, ndaj të denuarit të aplikohet dhënia e disa detyrimeve te parashikuara nga nenet 60 dhe 61 te K.Penal dhe qe verifikimi i zbatimit të këtyre detyrimeve nga i dënuari të realizohet nga organi i ngarkuar për mbikqyrjen e proves Zyra Vendore e Sherbimit te Proves ,të vendbanimit të tij.

Në mbështetje të nenit 389 të K.Pr.Penale duhet të deklarohet heqja e masës së sigurimit personal “Arrest në shtëpi” të parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale dhëne me vendimin Nr.1462/1 Akti ,datë 24.12.2021 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane .

Lidhur me detyrimin ligjor të Gjykates për të disponuar për provat materiale të sekuestruara në funksion të ketij procedimi penal, Gjykata bazuar në nenin 190 të K.Pr.Penale vendosi që:

Lënda narkotike e sekuestruar,të asgjësohet.

Lidhur me provat e tjera materiale,sendet e sekuestruara me procesverbalin e sekuestrimit dt.26.08.2021,t’i kthehen poseduesit.

Përsa i përket detyrimit ligjor për pagimin e shpenzimeve proceduriale hetimore e ato gjygesore të parapaguara nga shteti në referim të nenit 393 të K.Pr.Penale, këto të fundit i ngarkohen të pandehurit pasi atij i përket dënimi.

Për sa u analizua u provua me pretendimet e palëve në séance e provat shkresore të ndodhura në dosje pjesë përbërese e pandare e fashikullit gjyqësorë.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata në veshtrim të neneve 405,406 e vijues të K.Pr.Penale si dhe nenit 283/1 të Kodit Penal ,Gjykata

V E N D O S I:

-Deklarimin fajtor të të pandehurit Valmir Kastriot Luto,për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikeve”, të parashikuar nga neni 283/1 të Kodit Penal dhe dënimin e tij,me 5(pesë) vjet burgim.

-Në zbatim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, i zbritet 1/3 e dënimit, duke e dënuar përfundimisht të pandehurin Valmir Kastriot Luto, me 3 (tre) vjet e 4 (katër) muaj burgim.

-Në zbatim të nenit 59 të K.Penal urdhërohet:

1. Pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim duke filluar ky afat nga e nesërmja e shpalljes së këtij vendimi.

2. Vënia në provë e të dënuarit Valmir Kastriot Luto, për një periudhë kohe prej 3 (tre) vjet e 4 (katër) muaj burgim me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë veprë tjetër penale dhe të mos shoqërohet me persona të dënuar.

3. Gjate kohës së provës, i dënuari Valmir Kastriot Luto, të mbajë kontakte me Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës, të vendbanimit të tij.

-Heqjen e masës së sigurimit "Arrest në shtëpi" të parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale dhëne me vendimin Nr.1462/1 Akti ,datë 24.12.2021 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane.

-Prova materiale e sekuestruar lëndë narkotike, të asgjësohet.

-Shpenzimet procedurale të fazës së hetimeve paraprake si dhe shpenzimet gjyqësore, në ngarkim të të pandehurit.

-Kundër vendimit mund të bëhet ankim nga palët brenda 15 (pesëmbëdhjete) ditëve në Gjykatën e Apelit Tirane duke filluar ky afat nga e nesërmja e komunikimit të vendimit.

U shpall në Tirane, sot më datë 09.03.2022.

SEKRETARE

GJYQATAR

ORNELA BALLA

ARTAN GJERMËNI

Shpenzime gjyqësore:

Njoftime 1 copë x 150.00 Lekë - 150.00 Lekë

Shpenzime të Prokurorisë - 11 000. 00 Lekë